



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:076847

Datë: 16.08.2024

Numri i dokumentit: 06058006

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me praktikanten Djellza Makolli, në çështjen penale ndaj të pandehurës S.Z., me vendbanim në Rr. “...” nr. ..., komuna Ferizaj, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND../24, të datës 12.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurës S.Z., në njërën anë dhe përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS – Q.S., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.473/22, të datës 15.04.2022, për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 16.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr../2024, e datës 12.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurës S.Z., me vendbanim në Rr. “...” nr. ..., komuna Ferizaj, e lindur me datë ....., me numër personal ....në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS distrikti në Ferizaj në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.473/22 e datës 15.04.2022, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurës S.Z., për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.473/22 të datës 15.04.2022, e ka akuzuar të pandehurën S.Z., për veprën penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Më datë 07.08.2024, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor dhe në këtë shqyrtim gjyqësor bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 12.08.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. ./2024, në mes të pandehurës S.Z., me vendbanim në Rr. “...” nr. ..., komuna Ferizaj, e lindur me datë ..., me numër personal ... në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS distrikti në Ferizaj në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

### **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**2022:076848, datë 16.08.2024**

**Praktikantja:**

**Djellza Makolli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

**Dardan Maloku**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.